



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi ..... nga ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-4882 me datë 18.10.2019. dorëzuar nga parashtruesi ..... nga ..... **RREFUZOHET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka kompetenca për veprimi në lëndën me numër 12-4882 nga viti 2019, formuar pas denoncimit me numër 12-4882/1 me datë 18.10.2019.

Lënda me numër 12-4882 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-4882 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4882/1 me datë 18.10.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi ..... nga .....

Në denoncim flitet për akuza për mosrespektim të rregullativës ekzistuese ligjore në Sektorin për urbanizëm pranë komunës ..... Në rastin konkret bëhet fjalë për këtë: me planin urbanistik bërë në vitin 1995 dhe 1997, me kërkesë të qytetarëve të komunës ..... me vendbanim në rrugën ..... iu është lejuar mbindërtim, gjegjësisht zgjerim të shtëpisë nga ana veriore e shtëpisë, me çka parashtruesi i denoncimit i është lejuar zgjerim të shtëpisë në anën jugore të shtëpisë, mirëpo pas parashtrimit të ankesës dhe kërkuar nga ana e tij, e njëjta i është aprovuar nga Komuna edhe atij i është lejuar të bënë zgjerim të shtëpisë në anën veriore. Fqiu i cili jeton afër parashtruesit, e ka zgjeruar shtëpinë e tij më tepër sesa kufijt e lejuar të ndërtimit dhe ka hyrë në parcelën ndërtuese të tij me çka i është pamundësuar të zgjeron ballkonin e shtëpisë së tij. Pas ndërtimit të tij u ndryshua Plani urbanistik dhe parashtruesit të denoncimit me planin e tij përsëriu ia kthyen që zgjerimin e shtëpisë ta bënë në anën jugore dhe për këtë ndryshim ai ka qenë informuar në vitin 2015. Në lidhje me atë, ai me Kërkesë u drejtua deri tek Sektori për urbanizëm i komunës së ..... që t'i lejojnë zgjerim të shtëpisë në anën verior si të fqit të tij, por e njëjta nuk i është lejuar.

Me denoncimin e dorëzuar deri tek KSHPK parashtruesi kërkon që Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit ta hulumton rastin sepse në të njëjtin sipas tij, janë bërë veprime korruptive nga ana e organeve të komunës dhe është thyer rregullativa ligjore, kurse shpreson

qē KSHPK t'ia zgjidhē rastin e tij. Me denoncimin/kērkesēn si shtojcē ka dorēzuar edhe dokumentacion.

Gjatē rishikimit tē akuzave tē pērmabajtura nē denoncim, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit i merr parasyshē akuzat e parashtruesit dhe konstaton se akuzat e denoncimit nuk janē tē drejtuara kah person konkret dhe nē rastin bēhet fjalē pēr çēshtje lidhur me veprim kompetent tē organeve tjera kompetente nē RMV, dhe njēherit veprime konkrete janē ndērmarrē para mē shumē vitesh, gjē qē nēnkupton skadim tē afatit tē vjetērsimit pēr hapje tē veprave tē mundshme korruptive, tē cilat mund tē ngriten me bazē dyshimi pēr vepra penale tē bēra nga Kodi penal i Republikēs sē Maqedonisē sē Veriut, me çka vlerēsōn se Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit nuk ka elemente pēr veprim tē mētutjeshēm pēr rastin e lēndēs, denoncimi rrefuzohet kurse lēnda tē mbyllet dhe tē arkivohet.

Nē bazē tē tērē kēsaj tē shēnuar mē sipēr, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi sipas dispozitave tē kētij vendimi.

Dorēzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi  
Pas pērfundimit tē KSHPK  
Pērpunoi: J. C., kēshilltarē  
Miratoi: V. G., anētar i KSHPK

**КОМИСИОНИ СШТЕТЃОРОР ПЃР  
ПАРАНДАЛИМ ТЃ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarē: Biljana Ivanovska**